VENDIM
Nr. 992, datë 9.12.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.54, DATË 5.2.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, PROCEDURËS DHE MËNYRËS SË DHËNIES ME QIRA, ENFITEOZË APO KONTRATA TË TJERA TË PASURISË SHTETËRORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të aktit normativ nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve", të miratuar me ligjin nr.9967, datë 24.7.2008, dhe të neneve 784 e 801, të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja "f", e pikës 5, të kreut I, "Pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfiteozë, kriteret e konkurrimit, e drejta, kompetencat dhe afatet", ndryshohet, si më poshtë vijon:

"f) Shtesa në kontratë ose kontrata e re, në rastet kur në administrim të shoqërive, ndërmarrjeve shtetërore apo institucioneve shtetërore kanë mbetur pasuri shtetërore truall, me sipërfaqe jo më shumë se 1 000 (një mijë) m^2, që janë të pashfrytëzueshme për shkak se janë të rrethuara ose në kufi nga i njëjti pronar ose pronarë të tjerë dhe kur kjo sipërfaqe kërkohet të merret me qira nga i njëjti pronar.".

2. Tabela A, bashkëlidhur vendimit në fuqi, zëvendësohet me tabelën A, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

TABELA A
TARIFAT DYSHEME TË QIRASË MUJORE PËR NDËRTESAT SIPAS QARQEVE

NR.	QARKU	SPECIFIKIMI TERRITORIAL	TARIFA DYSHEME
1.	**Tiranë**	Në qytetin e Tiranës.	**300**
		Jashtë qytetit të Tiranës.	**150**
2.	**Berat**	Në qytetin e Beratit.	**100**
		Jashtë qytetit te Beratit	**50**
3.	**Dibër**	Në qytetin e Peshkopisë	**75**
		Jashtë qytetit të Peshkopisë	**50**
4.	**Durrës**	Në qytetin e Durrësit	**200**
		Jashtë qytetit të Durrësit	**150**
5.	**Elbasan**	Në qytetin e Elbasanit	**150**
		Jashtë qytetit të Elbasanit	**75**
6.	**Fier**	Në qytetin e Fierit	**150**
		Jashtë qytetit të Fierit	**100**
7.	**Gjirokastër**	Në qytetin e Gjirokastrës	**75**
		Jashtë qytetit të Gjirokastrës	**50**
8.	**Korçë**	Në qytetin e Korçës	**150**

		Jashtë qytetit të Korçës	**75**
9.	**Kukës**	Në qytetin e Kukësit	**75**
		Jashtë qytetit të Kukësit	**50**
10.	**Lezhë**	Në qytetin e Lezhës	**150**
		Jashtë qytetit të Lezhës	**100**
11.	**Shkodër**	Në qytetin e Shkodrës	**150**
		Jashtë qytetit të Shkodrës	**100**
12.	**Vlorë**	Në qytetin e Vlorës	**200**
		Jashtë qytetit të Vlorës	**100**